



VENDIMI DHE GJETJET

Data e miratimit: 19 qershor 2019

Nr. i lëndës: 2011-27

F. dhe të Tjerë

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 19 qershor 2019, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Guénaël METTRAUX, kryesues
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. Ronald Hooghiemstra, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit me 15 janar 2019,

I. AUTORITETI I PANELIT PËR PËRCJELLJEN E VENDIMEVE DHE REKOMANDIMEVE

1. Ky vendim është një vazhdim i një vendimi të marrë nga Paneli më 5 dhjetor 2017. Ai vendim është miratuar në përputhje me rregullën 45 e *tutje* të rregullores së punës së Panelit, e cila autorizon Panelin që të përcjell vendimet dhe rekomandimet e tij.
2. Kjo lëndë është në pritje në Panel që nga nëntori i vitit 2011.
3. Ankesa ka ngritur çështje veçanërisht të ndjeshme, si në lidhje me seriozitetin e shkeljes së të drejtave të ankuesit dhe bashkëshortit të sa, po ashtu edhe në lidhje me përfshirjen e Misionit.

4. Si rezultat i mandatit të kufizuar të Panelit dhe aftësisë për të ofruar mjete juridike, këto procedura nuk mund të shpresohet të riparojnë plotësisht dëmin e bërë ndaj të drejtave të ankueses dhe të bashkëshortit të saj. Mirëpo, Paneli shpreson se pranimi i shkeljes së këtyre të drejtave dhe shprehja e keqardhjes nga shefja e Misionit disi do të shërbejnë për të adresuar dhe korrigjuar dëmin e bërë ankueses.

II. PROCEDURA PRANË PANELIT

5. Ankesa në emër të bashkëshortes (më tutje përmendet si F.) dhe dy anëtarëve të familjes së të ndjerit X.F. ishte parashtruar në Panel me datën 14 nëntor 2011. Paneli ka miratuar kërkesën e parashtruesit të ankesës që emrat e tyre mos të zbulohen.
6. Paneli i ka komunikuar ankesën shefit të Misionit (ShM-së) me datën 16 tetor 2012 dhe ka kërkuar nga ai që të ofrojë komente me shkrim mbi pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e lëndës.
7. Më 17 janar 2013, ShM-ja ka ofruar komentet lidhur me pranueshmërinë e lëndës.
8. Më 9 prill 2013, një zyrtar i caktuar nga Misioni gojarisht i ka prezantuar Panelit faktet e caktuara që lidhen me zgjidhjen e ankesës.
9. Më 15 korrik 2015, Paneli i ka ofruar avokatit të ankuesve një kopje të një versioni të redaktuar të këtij prezantimi së bashku me një kërkesë për komentet e tij. Përgjigjja e ankueses ishte parashtruar në Paneli më 27 korrik 2015.
10. Më 30 tetor 2015, EULEX-it i ka paraqitur Panelit një raport të shqyrtimit të lëndës që në ndërkohë ishte kryer.
11. Në dy raste në vitin 2016, ShM-ja ka paraqitur parashtresa të mëtejshme për rastin, duke i tërhequr vëmendjen Panelit në lidhje me faktin se parashtresat e Misionit ishin konsideruar dokumente jopublike të BE-së dhe/ose mund të ndikojnë negativisht në procedimet penale në vazhdim.
12. Me vendimin e datës 13 qershor 2017, lënda ishte shpallur e pranueshme (<https://hrrp.eu/alb/docs/Decisions/2011-27%20Admissibility%20decision-a.pdf>).
13. Më 5 dhjetor 2017, Paneli ka marrë vendimin mbi bazueshmërinë e çështjes dhe ka konstatuar se Misioni kishte shkelur të drejtat themelore të ankueses dhe bashkëshortit të saj sipas neneve 2 (pjesët procedurale) dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (<https://hrrp.eu/alb/docs/Decisions/2011-27%20Decision%20and%20Findings-a.pdf>). Në atë vendim, Paneli gjithashtu ka bërë rekomandimet e mëposhtme për veprime korrigjuese:
 - SHM-ja duhet ta bëjë një deklaratë ku pranon se rrethanat e rastit përbëjnë shkelje të të drejtave të ankuesve që i atribuohen veprimeve dhe mosveprimeve të EULEX-it gjatë kryerjes të mandatit të tij ekzekutiv;

- SHM-ja duhet të shpërndaj këtë vendim lidhur me substancën e këtij rasti tek personeli i Misionit, detyra e të cilëve ka të bëjë me çështjen e këtij rasti, në mënyrë që të ofrohen udhëzime lidhur me standardet e zbatueshme të të drejtave të njeriut.
14. Përmes shkresës së datës 29 mars 2019, shefja e Misionit ka njoftuar Panelin se vendimi dhe gjetjet e tij ishin shpërndarë tek personeli i Misionit, detyrat e të cilëve ka të bëjë me subjektin e kësaj çështjeje. Shefja e Misionit gjithashtu ka thënë si në vijim:

“Do të doja të përsëris atë çfarë është thënë nga paraardhësit e mi dhe edhe njëherë t’i shpreh ngushëllimet e mi më të thella ankuesve në emër të EULEX-it Kosovë. Sipas mandatit të tanishëm, Misioni ka një kapacitet të kufizuar në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe është i angazhuar për të siguruar respektimin e plotë të standardeve të zbatueshme ndërkombëtare dhe praktikave më të mira evropiane”.

III. VENDIMI PASUES DHE VLERËSIMI NGA PANELI I HAPAVE TË NDËRMARRË NGA MISIONI

15. Paneli thekson që shefja e Misionit ka zbatuar plotësisht të parën nga dy prej rekomandimeve të Panelit.
16. Për më tepër Paneli gjithashtu thekson se përderisa nuk pranon zyrtarisht përgjegjësinë e Misionit për shkeljen e të drejtave të ankuesit, shefja e Misionit ka ndërmarrë hapin e vlefshëm për të shprehur ngushëllimet e saj më të thellë për ankuesin në emër të Misionit. Paneli shpreson që kjo si dhe pranimi i Panelit që të drejtat e saj dhe të drejtat e bashkëshortit të saj janë shkelur nga Misioni, do t’i sjellin ankueses njëfarë lehtësimi në lidhje me padrejtësinë që iu ishte bërë atyre.
17. Paneli mbyllë shqyrtimin e kësaj lënde.

Për Panelin,

Guénaél Mettraux
Kryesues



Anna Bednarek
Anëtare